



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, neni 17, pika o dhe neni 40, paragrafi 40.2, pika i të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008"), të nenit 24 të Ligjit nr. 04/L - 071, për sistemin e adresave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 29/27, dhjetor 2011), të Udhëzimit administrativ, nr. 17/2019, për krijimin e listës alfabetike për emërtime të listës rezervë dhe vendosjen e tyre në regjistrin komunal të adresave, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të datës 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 31.03.2023, merr këtë

## V E N D I M

### I.

Miratohet Vendimi për caktimin Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet.

### II.

Anëtarë të Komisionit, të cekur në pikën I të këtij vendimi, janë:

1. Berna Saraçi, LVV, anëtare,
2. Gëzim Sveçla, LVV, anëtar,
3. Fiknete Bejta, LDK, anëtare,
4. Amir Simnica, LDK, anëtar,
5. Muhamet Selmani, PDK, anëtar,
6. Bahri Gashi, AAK, anëtar,
7. Sami Boroci, AKR, anëtar,
8. Endrit Zabërgja, NISMA, anëtar,
9. Donjeta Sahatçiu, nënkryetare e Komunës, anëtare,
10. Doruntinë Maloku, drejtoare e Drejtorisë së Pronës, anëtare,
11. Veton Krasniqi, përfaqësues i Drejtorisë së Urbanizmit, anëtar.

### III.

Detyrë e Komisionit është bashkëpunimi me drejtoritë komunale, ku duhet të veprojnë në harmoni me dispozitat e Ligjit nr. 04/L - 071, për sistemin e adresave dhe rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet.

IV.

Pas përfundimit të punës së këtij komisioni, listat me emërtimet e propozuara të paraqiten në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT  
01-020/05-69249/23, më 03.04.2023

KRYESUESI I KUVENDIT  
Fehmi Kupina

